



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:249762
Datë: 07.12.2023
Numri i dokumentit: 05030814

C-IV.-14-4919

Parashtruesi i kërkesës

A K, Fshati T, Podujevë.

Kundër

Pala kundërshtare

N.SH “Gërmia” në likuidim, përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakërishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 07 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 23 qershor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN093-0093 të datë 03 qershor 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin e mjeteve të asistencës sociale në shumë prej 1,500 €, ndaj N.SH “Gërmia” (në likuidim).

Me 12 tetor 2023, gjykata lëshoj një vërejtje për ankuesin mbi pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje ankuesi u informua se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Vërejtja, e lartë cekur së bashku me urdhërpagesë, i është dorëzuar ankuesit me 23 tetor 2023 dhe se gjer me datën e lëshimit të këtij vendimi taksa gjyqësore nuk është paguar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS (Ligji nr. 06/L-086) parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Ankuesi komform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së *ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.*

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

Në qoftë se paditësi/ja nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Me 12 tetor 2023, gjykata përmes vërejtjes kërkoj nga ankuesi, që të bëj pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëj pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS-së në lidhje me udhëzimin e KGJK-së Nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Vërejtja ishte pranuar nga ankuesi me datë 23 tetor 2023, mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar